



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
AGJENCISË PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS
PËR VITIN 2019**

Prishtinë, qershor 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

“ETIKA Co” Shpk ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në konsultim me menaxherin e kontratës Mujë Gashi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga ETIKA Co shpk, nga Ymer Mehmeti, udhëheqës i ekipit si dhe Burim Selmani, anëtar i ekipit.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	7
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	12
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja.....	12
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	15

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Procesi i përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore ishte menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli - në përgjithësi kishte kontrolle të mira në raport me obligimet statusore të saj, megjithatë në kemi vërejtur dobësi në mos regjistrimin e pasurive jo kapitale nën 1,000€, si dhe raportim jo i drejtë i obligimeve të papaguara.

ANJ-ja në raportin e vitit të kaluar nuk kishte rekomandime.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Menaxhmenti i ANJF-së është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do të adresoj rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (më tutje ANJF) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Drejtori Ekzekutiv dhe Zyrtaari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ANJF-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyesh mërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

ANJF në përgjithësi ka kontrole të duhura në raport me obligimet statusorë të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Megjithatë, nevojiten kontrole të duhura sa i përket regjistrimit të pasurive nën 1,000€ dhe raportimit të obligimeve të papaguara.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	406,135	404,632	395,971	98%	352,458	317,598
Granti i Qeverisë – Buxheti	406,135	345,923	339,706	98%	335,656	317,598
Donacionet e jashtme	-	58,709	56,265	96%	16,802	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,503€. Ky zvogëlim është rezultat i vendimeve të Qeverisë.

Në vitin 2019, ANJF-ja ka shpenzuar 98% të buxhetit final ose 395,971€, me një përkeqësim prej 1% krahasuar me vitin 2018. Megjithatë, se si është realizuar buxhetit në nivel të kategorive janë dhënë më poshtë shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	406,135	404,632	395,971	98%	352,458	317,598
Pagat dhe Mëditjet	213,026	228,275	226,294	99%	184,789	176,874
Mallrat dhe Shërbimet	183,109	170,357	163,691	96%	161,169	133,633
Shërbimet komunale	10,000	6,000	5,985	100%	6,500	7,091

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

- Buxheti final në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 15,249€ pagesën e gjithsej 12 (dymbëdhjetë) zyrtarëve, për Ofrimin e Ndihmës Juridike Falas përmes zyrave mobile në dhjetë komuna të Republikës së Kosovës;
- Në dy kategoritë, mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunal, buxheti final ishte zvogëluar për vlerën 12,752€, respektivisht 4,000€, si rezultat i vendimit të qeverisë për kursime buxhetore.

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për 2019 ishte 228,275€, ndërsa ishin shpenzuar 226,294€. Numri i aprovuar i të punësuarve sipas buxhetit ishte 28 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 25. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 4 të rinj. Kemi testuar 40 mostra për teste substanciale në vlerë 25,716€, si dhe 7 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 170,357€, prej tyre ishin shpenzuar 163,691€. Ndërsa buxheti i komunal prej 6,000€ ishte shpenzuar 5,985€.

Këto shpenzime kanë të bëjnë kryesisht me shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës si dhe me shpenzime tjera si qiraja për ndërtesa, furnizim për zyre, shpenzime të udhëtimit, shpenzime për telefoni mobile, shpenzimet komunale si dhe shërbime/furnizime të tjera.

Për këto shpenzime, ne kemi testuar 45 mostra për teste substanciale në vlerë 22,642€ si dhe 17 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 1,461€, pasurive jokatitale është 1,261€, si dhe e stoqeve 7,861€. Kemi testuar 20 mostra për teste substanciale në vlerë 4,710€, si dhe dy (2) mostra për teste të pajtueshmërisë. Lidhur me testet tona, ne kemi vërejtur si në vijim:

Çështja A1³ - Mos regjistrimi i pasurive jo kapitale

Gjetja Sipas nenit 6 paragrafi 3 i Rregullores me Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që - pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”.

Gjatë testimeve kemi vërejtur që dy pagesa në vlerë 4,710€, njëra për furnizim për zyrë (kompjuter) në vlerë 4,200€ kurse tjetra për blerjen telefonave për zyrë në vlerë 510€ nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive nën 1,000€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrollit jo të mirë që pasuria të regjistrohet në regjistrat e saj.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive në regjistrat përkatës reflekton me prezantim jo të drejtë të pasurisë në PFV-të.

Rekomandimi A1 Drejtori Ekzekutiv duhet t’i sigurojë të gjitha pasuritë janë të regjistruara në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.

2.3 Detyrimet

2.3.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 6,737€⁴. Këto detyrime janë bartur për t’u paguar në vitin 2020. Lidhur me testet tona, ne kemi identifikuar si në vijim:

³ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritur

⁴ Kjo shumë është prezentuar nga entiteti i audituar

Çështja A2 – Vonesë në pagesë dhe dobësi në raportimin e obligimeve të papaguara

Gjetja Sipas rregullores financiare 02/2013 për Raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore, neni 5 dhe 6, citon që raportet e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore duhet të dorëzohen në afat prej 15 ditë pas përfundimit të muajit, për gjendjen e muajit paraprak. Kurse sipas dispozitave të nenit 39, paragrafi 1, të LMFP, obligim i vonuar për pagesë i organizatës buxhetore konsiderohet fatura e cila nuk është paguar 30 ditë pas pranimit të faturës.

ANJF kishte raportuar çdo muaj në MF për obligimet e papaguara. Mirëpo në katër pagesave apo fatura ato ishin detyrime në muaj të caktuar mirëpo nuk ishin raportuar si të tilla në MF. Madje, prej tyre kishte vonesë në pagesë nga një muaj deri në katër muaj.

Ndikimi Vonesa në pagesa dhe mos raportimi me kohë i obligimeve mujore ndikon në raportim jo të drejtë si dhe rrit rrezikun që faturat të mos identifikohen dhe të mos paguhen me kohë.

Rekomandimi A2 Drejtori ekzekutiv duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara ligjore, ndërsa ato që kanë kaluar afatin e pagesës të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve mujore në MF.

2.3.2 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve të kontingjente e paraqitur në PFV ishte 0.00€⁵. Nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.3.3 Detyrimet kontraktuale

Pasqyra e detyrimeve kontraktuale në fund të vitit 2019, ishte 23,339€⁶. Nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Në bazë të kërkesave ligjore, ANJF-ja nuk i plotëson kriteret për themelimin e NjAB-së. Për vitin 2019, Ministria e Financave përkatësisht NJAB e saj kishte kryer një auditim për funksionimin e Agjencisë për Ndihmë Juridike duke dhënë dy rekomandime, për të cilat menxhmenti ishte në proces të adresimit. Nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim në këtë fushë.

⁵ Kjo shumë është prezantuar nga entiteti i audituar

⁶ Kjo shumë është prezantuar nga entiteti i audituar

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Në raportin tonë të auditimit për PFV-të e vitit 2018, ne nuk kemi dhënë asnjë rekomandim. Ndërsa lidhur me auditimin e vitit 2019, ne kemi dhënë një përshkrim në Tabelën 3.

Tabela 3 Përmbledhja e rekomandimeve për vitin 2019

Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019
1	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Drejtori Ekzekutiv duhet t'i sigurojë të gjitha pasuritë janë të regjistruara në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë.
2	Detyrimet e papaguara	Drejtori ekzekutiv duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara ligjore, ndërsa ato që kanë kaluar afatin e pagesës të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve mujore në MF.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keq deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme

dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit



157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit për vitin 2019 dhe për
implementimin e rekomandimeve

Nga: Agjencia për Ndihme Juridike Falas

Për: "Etika - Co" SHPK

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare të ANJF-së, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Anita Alaj Kalanderi
Drejtoresh Ekzekutive

Data: 26.05.2020, Prishtinë,

